



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 134 Vendimi

Tiranë, më 04.04.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Olsi Komici	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, pas shortimit të shpërndarjes së çështjes, caktimit të kryetarit dhe relatorit, më datë 04.04.2018, ora 14:00, në sallën nr. 1, të selisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Petrit Fusha, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë.**

BAZA LIGJORE: Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Nenet 14 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Neni 64, pika 1, germa “a” dhe neni 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Fusha, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e Prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Fusha, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur, më datë 15.01.2018, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Në mbledhjen e trupit gjykues, më datë 30.01.2018, u deklarua mungesa e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ.
4. Me vendimin nr. 40, datë 16.07.2017, “Për rishpërndarjen me short dhe transferimin e dosjeve të çështjeve të komisionerit Alma Faskaj”, nëpërmjet procedurës së shortit, anëtarja e trupit gjykues, znj. Alma Faskaj, për arsye shëndetësore, u zëvendësua me anëtarën Valbona Sanxhaktari. Më datën 10.09.2018, subjektit të rivlerësimit iu njoftua përbërja e re e trupit gjykues dhe më datë 11.09.2018 subjekti konfirmoi mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, më datë 26.02.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Fusha, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Më datë 27.02.2019, subjektit të rivlerësimit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ kryesisht si dhe ju kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
8. Konstatohet se, z. Petrit Fusha, ka ushtruar detyrën e prokurorit/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga muaji korrik i vitit 2013 deri në dorëzimin e deklaratës së pasurisë – shtojca 2 dhe në vazhdim detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, deri më 28.02.2019, ditë në të cilën ka dhënë dorëheqjen nga detyra.
9. Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Fusha, me shkresën nr. *** prot., datë 28.02.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me lëndë: “Dorëheqje nga detyra e prokurorit”, ka paraqitur dorëheqjen nga detyra e prokurorit. Kërkesa është bazuar në nenin G të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 64, 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në pikat 35 dhe 36 të vendimit nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

10. Ky dokument i është dërguar edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me shkresën nr. 1390 prot., datë 05.03.2019, protokolluar në Komision.

11. Në vijim, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. 37, datë 06.03.2019, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Petrit Fusha, aktualisht prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në datën 31 mars 2019, për arsye të kërkesës për dorëheqje. Ky vendim është marrë në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 64, pika 1, germa “a” dhe neni 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

12. Me kërkesën nr. *** prot., datë 06.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendimi nr. 37, datë 06.03.2019, u vu në dispozicion të Komisionit, më datë 12.03.2019.

13. Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Fusha, me shkresën “Njoftim”, datë 14.03.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.03.2019, ka njoftuar Komisionin në lidhje me procedurat e kryera për dhënien e dorëheqjes së parevokueshme nga detyra e prokurorit dhe largimin nga shërbimi i Prokurorisë, deklarimin nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të mbarimit të statusit të magjistratit për arsye të dorëheqjes, me vendimin nr. 37, datë 06.03.2019, duke kërkuar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TE RIVLERËSIMIT

14. Pasi mori në shqyrtim dosjen e plotë të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme, Komisioni, konstatoi se, z. Petrit Fusha, ka ushtruar funksionin e prokurorit në periudhën dhjetor 1997 deri më 28.02.2019, datë në të cilën ka dhënë dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

15. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. 37, datë 06.03.2019, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, më datë 31.03.2019, për shkak të dorëheqjes, të prokurorit Petrit Fusha, mbështetur në nenin 64, pika 1, germa “a” dhe neni 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

16. Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon :

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

Neni 56 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit, ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".

17. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.”

Në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

i) Në nenin 64, pika 1, germa “a”, përcaktohet se:

1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:

a) Jep dorëheqjen;

b)

ii) Në nenin 65, përcaktohet se:

1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

18. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Fusha, ka filluar në respektim të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

19. Me paraqitjen e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, Komisioni, është vënë në dijeni të kërkesës për dorëheqje të subjektit të rivlerësimit “nga funksionet e magjistratit” dhe Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për mbarimin e këtij statusi më datë 31 mars 2019.

Komisioni, çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta për dorëheqje duke kryer të gjithë procedurën e duhur ligjore.

Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, ai humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit “G” të Aneksit të Kushtetutës,

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin “G” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Fusha, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, më datë 04.04.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim Hamitaj
Kryesues

Olsi Komici
Relator

Valbona Sanxhaktari
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha